



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**RREGULLORE (QRK) - Nr. 23/2023**  
**PËR PROCEDURAT E PUNËS NË TRYEZAT MULTIDISIPLINARE**  
**PËR NDIHMË NË MENAXHIMIN**  
**E RASTIT<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Rregullore (QRK) - nr. 23/2023 për procedurat e punës në tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit, është aprovuar në mbledhjen e 180-të, të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr. 14/180, datë 27.12.2023

## **Qeveria e Republikës së Kosovës**

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 21 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, nenin 8 (4.5) Ligjit nr.08/1-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës si dhe nenin 19, paragrafi 6, nën-paragrafi 6.2 të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë,

Miraton:

# **RREGULLORE (QRK) - Nr. 23/2023 PËR PROCEDURAT E PUNËS NË TRYEZAT MULTIDISCIPLINARE PËR NDIHMË NË MENAXHIMIN E RASTIT**

## **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i procedurave të punës së Tryezave Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit (në tekstin e mëtejshëm: Tryeza Multidisiplinare).

### **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të detyrueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët marrin pjesë dhe janë përgjegjës në ndihmë për menaxhimin e rastit dhe mbrojtjen e fëmijës.

## **KAPITULLI II TRYEZA MULTIDISCIPLINARE**

### **Neni 3 Themelimi i Tryezës Multidisiplinare**

Çdo komunë në Republikën e Kosovës themelon Tryezën Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit në nivel profesionistësh.

## **Neni 4**

### **Përbërja e Tryezave Multidisiplinare**

1. Tryeza Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit, ka këtë përbërje:

- 1.1. Menaxheri i rastit nga Qendra përkatëse për Punë Sociale;
- 1.2. Ndhmës menaxheri i rastit nga QPS;
- 1.3. Zyra për Mbrojtje dhe Ndhmë të Viktimave - Mbrojtësi i Viktimave;
- 1.4. Shërbimi Sprovues i Kosovës - Zyrtari i Shërbimit Sprovues;
- 1.5. Qendra e Mjekësisë Familjare – mjekë specialistë sipas specifikave të rastit;
- 1.6. Policia e Kosovës;
- 1.7. Qendra për Shëndet Mendor – specialist i fushës për trajtimin e fëmijëve;
- 1.8. Drejtoria Komunale për Arsim - Zyrtar për Arsim;
- 1.9. Drejtoria Komunale për Mirëqenie Sociale – Zyrtari përgjegjës;
- 1.10. Psikologu/Punëtori, Social/Pedagogu i Shkollës ose përfaqësues i deleguar nga institucioni edukativo-arsimor;
- 1.11. Zyra Komunale për Komunitete - Zyrtari për Komunitet;
- 1.12. Institucioni për Strehim Përkujdesës ose familja strehuese;
- 1.13. Zyra Komunale për të Drejtat e Njeriut - Zyrtari për të Drejtat e Njeriut/Fëmijës;
- 1.14. Përfaqësues të Organizatave Joqeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

2. Tryeza Multidisiplinare kryesohet nga Menaxheri i rastit, i cili është zyrtar i shërbimeve sociale i caktuar nga Qendra për Punë Sociale (në tekstin e mëtejme: QPS).

3. Menaxheri i rastit varësisht nga vlerësimi i nevojave, e bënë përzgjedhjen e përbërjes së përfaqësuesve nga paragrafi 1 apo 6 i këtij neni, të cilët duhet të marrin pjesë në Tryezë për shqyrtimin dhe trajtimin e rastit të caktuar.

4. Përjashtimisht nga paragrafi 1 dhe 6 të këtij neni, Menaxheri i rastit mund të ftojë edhe profesionistë të tjerë relevant që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve.

5. Pjesëmarrës në Tryezën Multidisiplinare mund të jenë edhe fëmija dhe prindi nëse nuk është ushtrues i dhunës apo kujdestari ligjor.

6. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në rastet kur fëmija është azilkërkues, pa-shtetësi, refugjat apo migrant, përbërjes së Tryezës, duhet t'i shtohen edhe përfaqësues tjerë relevantë si në vijim:

6.1.Zyrtarë nga Departamenti për Shtetësi Azil dhe Migrim pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme;

6.1.1. Zyrtarë nga Qendra për Azil;

6.1.2.Zyrtarë nga Qendra për Mbajtjen e të Huajve;

6.1.3. Zyrtarë nga Qendra për Pranim dhe Regjistrim të Migrantëve;

6.1.4.Zyrtarë nga Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme;

6.1.5.Organizatave Ndërkombëtare që kanë mandat specifik në fushën e Refugjatëve, Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Migrimin.

## **Neni 5**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Tryezës Multidisiplinare**

1. Tryeza Multidisiplinare nën udhëheqjen e menaxherit të rastit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1.1.trajton rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore në bazë të interesit më të mirë të fëmijës.

1.2. përcjell dhe në vazhdimësi rishqyrton vlerësimin e rastit të bërë paraprakisht nga menaxheri i rastit, duke e plotësuar me informata të përditësuara varësisht nga ndryshimi i gjendjes së fëmijës apo rrethanave në rast.

1.3.bashkërendon dhe zhvillon procesin e planifikimit të përbashkët të veprimit për mbrojtje të fëmijës në përputhje me rrethanat dhe me legjislacionin përkatës në fuqi;

1.4.koordinon ofrimin e shërbimeve për mbrojtje, rehabilitim, dhe integrim apo riintegrim të fëmijës, në mënyrë të qëndrueshme dhe përkrah familjet e tyre ose kujdestarin;

1.5.rishikon planin individual për mbrojtjen e fëmijës në baza mujore, në raste specifike edhe më shpesh.

1.6.harton raportin vjetor për punën e vet dhe raporton tek Komuna dhe sipas kërkesës edhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit për të Drejtat e Fëmijës.

2.Tryeza Multidisiplinare mbyll rastin kur vlerësohet se të gjitha shërbimet e nevojshme janë ofruar dhe është ulur niveli i rrezikut apo nuk ka rrezik për mirëqenien e fëmijës.

## **Neni 6**

### **Udhëheqësi i Tryezës Multidisiplinare**

1. Udhëheqësi i Tryezës Multidisiplinare, i cili është Menaxher i rastit ka këto kompetenca:

- 1.1. organizon dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës së përgjithshme të Tryezës për rastin e caktuar;
- 1.2. kryen dhe ndërmer veprime në të mirë të punës së Tryezës;
- 1.3. thërret takimin e Tryezës në bashkëpunim me udhëheqësin e shërbimeve sociale të QPS-së;
- 1.4. kryeson takimet e Tryezës;
- 1.5. paraqet në Tryezë planin fillestar individual për rastin nga QPS;
- 1.6. shqyrton, trajton dhe harton Planin e unifikuar të shërbimeve për rastin në bashkëpunim me anëtarët e Tryezës;
- 1.7. mbikëqyrë zbatimin e planit individual të unifikuar në bashkëpunim me anëtarët e Tryezës;

## **Neni 7**

### **Anëtarët e Tryezës Multidisiplinare**

Secili anëtar i Tryezës Multidisiplinare ofron shërbime të nevojshme në interesin më të mirë të fëmijës, në kuadër të mandatit që ka institucioni që përfaqëson.

## **Neni 8**

### **Takimet**

1. Tryeza Multidisiplinare mbanë takime për çdo referim dhe vlerësim të rastit specifik.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, edhe kur nuk ka raste për trajtim, Tryeza mbanë takim së paku një (1) herë në tre (3) muaj për vlerësimin e situatës së përgjithshme të rrezikshmërisë së mirëqenies së fëmijëve në kuadër të Komunës përkatëse.
3. Menaxheri i rastit në bashkëpunim me udhëheqësin e shërbimit social të QPS-së, pajtohen për datën e takimit për rastin që do të trajtohet nga Tryeza. Menaxheri i rastit e dërgon ftesën, rendin e ditës, informatat relevante që do të shqyrtohen në takimin e tryezës, jo më vonë se tre (3) ditë para datës së takimit.
4. Takimin e Tryezës mund të inicojnë edhe një (1) apo më shumë anëtarë të tryezës, në këtë rast menaxheri i rastit e thërret takimin.
5. Menaxheri i rastit sipas nevojës mund të ftoj në takim përfaqësues të institucioneve të cilat janë të ndërlidhur drejtpërdrejt në trajtimin e rastit.

6. Në takimin e radhës së Tryezës, për rishikim të rastit, ftohen të njëjtit akterë nga takimi paraprak dhe nëse konsiderohet e nevojshme mund të ftohen edhe profesionistë tjerë.

7. Anëtarëve i'u dërgohet një kopje e vlerësimit dhe planit fillestar individual së paku tre (3) ditë para takimit.

8. Përjashtimisht nga paragrafi 7 i këtij neni, aty ku nuk është e mundshme të bëhet vlerësimi paraprak në një rast me rrezik, informatat sigurohen në takim.

9. Secili anëtar i Tryezës i përfshirë në rast, paraqet raport me shkrim për progresin për rastin së paku tre (3) ditë para takimit të radhës.

10. Menaxheri i rastit të QPS, e njofton tryezën se janë njoftuar prindi ose kujdestari dhe fëmija për mbajtjen e takimit dhe nëse ata mungojnë në takim, njoftohet tryeza me qëndrimet e tyre të cilat duhen marrë parasysh.

11. Kur menaxheri propozon mbylljen e rastit në Tryezën Multidisiplinare, në takim ftohen të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në trajtimin e rastit.

### **Neni 9 Pjesëmarrja në takime**

Në takimet e Tryezës Multidisiplinare, marrin pjesë të gjithë anëtarët të cilët ndihmojnë në menaxhimin e rastit.

### **Neni 10 Mbajtja e takimit**

1. Për çdo takim të Tryezës mbahet procesverbal, i cili miratohet në takimin e radhës dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Tryezës.

2. Cilido anëtarë i Tryezës nuk merr pjesë në shqyrtimin e ndonjë rasti për të cilin ai ka konflikt interesi në pajtim me legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesit.

3. Tryeza zhvillon takimin sipas rendit të ditës së miratuar.

4. Menaxheri i rastit paraqet informatat për rastin, vlerësimin e nevojave, shërbimet e ofruara dhe një propozim plan të shërbimeve për menaxhimin e rastit.

5. Prindi ose kujdestari dhe fëmija mund të ftohen në takime të Tryezës për të shprehur mendimet e tyre.

6. Takimet e Tryezës janë të mbyllura dhe të gjithë anëtarët ruajnë fshehtësinë e informatave për rastin në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## **KAPITULLI III**

### **PROCEDURA PËR MENAXHIMIN E RASTIT NË TRYEZËN MULTIDISCIPLINARE**

#### **Neni 11**

##### **Procedura në menaxhimin e rastit**

1.Procedura e menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje që zhvillohet nga Tryeza Multidisiplinare, përfshinë:

- 1.1.vlerësimin e rastit;
- 1.2.hartimin e planit individual të unifikuar për mbrojtjen e fëmijës;
- 1.3.zbatimin e planit individual të unifikuar;
- 1.4.rishikimin e planit dhe progresit, dhe
- 1.5.mbylljen e rastit.

#### **Neni 12**

##### **Vlerësimi i rastit në Tryezën Multidisiplinare**

1.Pas pranimit të vlerësimit fillestar të rastit nga Menaxheri i QPS për mbrojtjen e fëmijës, Tryeza Multidisiplinare ndërmer të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për verifikimin e informacionit të pranuar dhe shqyrtimin e rastit.

2. Bazuar në vlerësimin fillestar nga menaxheri i rastit, Tryeza Multidisiplinare bënë vlerësimin gjithëpërfshirës të rastit, ripërcakton nivelin e rrezikut dhe plotëson informatat nga anëtarët e Tryezës Multidisiplinare për gjendjen në të cilin ndodhet fëmija.

3.Për të siguruar mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës, vlerësimi nga Tryeza, përfshinë indikatorët e mirëqenies, por pa u kufizuar në:

- 3.1.sigurinë e fëmijës dhe nivelin e rrezikut;
- 3.2.nevojat esenciale si: strehimi, ushqimi, higjiena dhe kujdesi shëndetësor;
- 3.3. përfshirjen në edukim në përputhje me moshën dhe specifikat e fëmijës;
- 3.4. kujdesin prindëror dhe familjar;
- 3.5. përfshirjen sociale.

4.Të gjitha të dhënat e mbledhura evidentohen në formularin për vlerësimin e rastit.

5.Vlerësimi gjithëpërfshirës duhet përfunduar në përputhje me afatet e parapara në standardet minimale të cilësisë.

### **Neni 13**

#### **Plani individual i unifikuar për mbrojtjen e fëmijës**

1.Për secilin rast, hartohet plani individual i unifikuar për mbrojtje të fëmijës, bazuar në vlerësimin e rrezikut, i cili përmban veprimet, masat dhe shërbimet e identifikuara të domosdoshme për të ulur nivelin e rrezikut.

2.Plani individual i unifikuar i shërbimeve për mbrojtje të fëmijës përfshinë, por pa u kufizuar:

2.1.përcaktimin e objektivave dhe veprimeve në punën me fëmijën dhe familjen me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe realizimit të të drejtave të fëmijës;

2.2.përcaktimin e anëtarëve përgjegjës nga Tryeza Multidisiplinare për zbatimin dhe koordinimin e veprimeve konkrete në plan;

2.3.ofrimin e shërbimeve të nevojshme nga institucionet përkatëse;

2.4.afatet kohore brenda të cilave duhet të ndërmerren veprimet e përcaktuara në këtë rregullore.

3.Menaxheri i rastit e dërgon tek anëtarët e Tryezës Multidisiplinare planin individual të unifikuar dhe përgatitur në takimet e Tryezës.

### **Neni 14**

#### **Zbatimi dhe monitorimi i planit nga menaxheri i rastit**

1.Menaxheri i rastit është përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e planit individual të unifikuar për mbrojtjen e fëmijës.

2.Secili anëtarë i Tryezës Multidisiplinare i caktuar në zbatimin e planit individual të unifikuar për mbrojtjen e fëmijës është përgjegjës për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në plan.

3.Menaxheri i rastit në pajtim me planin individual të unifikuar për mbrojtjen e fëmijës, ndër të tjera ka përgjegjësi:

3.1.të kërkoj informacion dhe raport nga anëtarët e Tryezës Multidisiplinare të përcaktuar në plan;

3.2.të njoftoj eprorin e institucionit përkatës në rast të mos bashkëpunimit nga anëtari i Tryezës i caktuar në plan;

3.3.të kërkojë informacion sipas afateve të përcaktuara në plan për realizimin e masave, veprimeve dhe shërbimeve të tjera;

3.4.të njoftojë Tryezën mbi zbatimin e planit dhe të gjeturat gjatë monitorimit të rastit.

4. Varësisht nga ecuria dhe procesi i monitorimit të zbatimit të planit, menaxheri i rastit thërret takimin e Tryezës për rivlerësimin e nivelit të rrezikut dhe të nevojave të fëmijës dhe familjes.



- 5.Për rastet me rrezikshmëri, menaxheri i rastit ka të drejtë të thërret takim të jashtëzakonshëm.
- 6.Menaxheri i rastit i përditëson të dhënat për rastin në formularin e shqyrtimit të monitorimit, ndryshon dhe plotëson planin individual të unifikuar për mbrojtjen e fëmijës.

### **Neni 15** **Rishikimi i planit dhe vlerësimi i progresit**

- 1.Menaxheri i rastit e thërret takimin për rishikimin e planit dhe vlerësimin e progresit.
- 2.Menaxheri i rastit së bashku me anëtarët e Tryezës e vlerësojnë ofrimin e shërbimeve dhe konstatojnë progresin e arritur për mirëqenien e fëmijës.
- 3.Anëtarët e Tryezës sipas nevojës mund ta ndryshojnë planin individual të unifikuar.

### **Neni 16** **Monitorimi i zbatimit të planit individual të unifikuar për mbrojtjen e fëmijës**

- 1.Udhëheqësi i shërbimeve sociale në QPS është përgjegjës për monitorimin e punës së menaxherit të rastit për zbatimin e planit individual të unifikuar për mbrojtjen e fëmijës.
- 2.Udhëheqësi i shërbimeve Sociale në QPS sipas nevojës realizon vizita monitoruese me qëllim të verifikimit të situatës së fëmijës dhe familjes për monitorimin e zbatimit të planit individual.

### **Neni 17** **Mbyllja e rastit në Tryezën Multidisiplinare**

1. Menaxheri i rastit e bënë vlerësimin e rastit dhe i rekomandon Tryezës Multidisiplinare mbylljen e rastit.
- 2.Para mbylljes së rastit në Tryezën Multidisiplinare, menaxheri kërkon mendimin e fëmijës kur kjo është e mundur dhe të prindit ose kujdestarit ligjor lidhur me ecurinë dhe mbylljen e rastit.
- 3.Tryeza Multidisiplinare e mbyll rastin nëse vlerësimi i menaxherit të rastit, i aprovuar paraprakisht nga Udhëheqësi i Shërbimeve Sociale, vlerëson se:
  - 3.1.masat, veprimet dhe shërbimet e tjera të ofruara sipas planit kanë përfunduar dhe fëmija është jashtë rrezikut;
  - 3.2.fëmija ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare;
  - 3.3.nëse fëmija e ndërron vendbanimin nga një komunë në tjetrën dhe procesi i menaxhimit të rastit bartet në QPS-në tjetër;
  - 3.4.nëse fëmija e ndërron vendbanimin duke u vendosur jashtë shtetit, transferohet në shtetin e origjinës (lindjes) apo në një vend të tretë bazuar në interesin më të mirë të fëmijës;

3.5.nëse fëmija vdes.

4.Në rast se vlerësohet se fëmija pas arritjes së moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeçare ka nevojë për vazhdimin e shërbimeve, rekomandohet marrja e shërbimeve të përshtatshme në përputhje me nevojat e individit.

5.Menaxheri i rastit dhe anëtarët e Tryezës Multidisiplinare nënshkruajnë formularin për mbylljen e rastit nga format profesionale të punës në menaxhim të rastit, i cili bëhet pjesë e dosjes individuale të fëmijës.

### **Neni 18** **Mbrojtja e së drejtës për privatësi**

1.Të gjitha të dhënat dhe veprimet që ndërmerren në rastet e trajtimit në kuadër të Tryezës Multidisiplinare duhet të trajtohen në privatësi në pajtim me Ligjin përkatës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave, përjashtimisht rasteve kur ndarja e tyre ndërmjet profesionistëve apo institucioneve të caktuara përbën detyrim ligjor.

2.Të gjithë anëtarët e Tryezës Multidisiplinare dhe pjesëmarrësit e tjerë në Tryezë janë të obliguar të nënshkruajnë deklaratën për ruajtjen e fshehtësisë.

### **Neni 19** **Bashkëpunimi**

Tryeza bashkëpunon me të gjitha institucionet relevante që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës në pajtim me Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës, përfshirë organizatat vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e fëmijës.

### **Neni 20** **Shtojcat**

1.Pjesë e kësaj Rregulloreje është:

1.1.Formulari për punën e Tryezës për ndihmë në menaxhimin e rastit.

### **Neni 21** **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

**Kryeministër i Republikës së Kosovës**  
**05 Janar, 2024**

**Shtojca 1:**

<b>Formë pune e Tryezës për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit</b> <i>Dokument për përdorim të brendshëm me qëllim të përgatitjes së kompletuar të një rasti për diskutim me anëtarët e TNMR-së</i>	
<i>Numri i lëndës:</i>	
<i>Data takimit të mbajtur të TNMR-së</i>	
<i>Qendra për Punë Sociale</i>	
<i>Udhëheqësi i TNMR / menaxheri i rastit</i>	
<i>Referuesi</i>	

**Rastet specifike të fëmijëve me rrezikshmëri që trajtohen nga TNMR**

<b>KEQTRAJTIMI</b>
<input type="checkbox"/> dhunë fizike
<input type="checkbox"/> dhunë psikologjike
<input type="checkbox"/> dhunë seksuale
<input type="checkbox"/> ndëshkim trupor
<input type="checkbox"/> fëmijë në forma të rrezikshme të punës
<input type="checkbox"/> rrëmbimi
<input type="checkbox"/> tjera:

<b>ABUZIMI SEKSUAL</b>
<input type="checkbox"/> abuzim seksual
<input type="checkbox"/> trafikim me fëmijë
<input type="checkbox"/> pornografi me fëmijë
<input type="checkbox"/> tjera:

### ABUZIM EMOCIONAL

- dhuna psikologjike
- ngacmim
- diskriminim
- martesë të hershme me dhunë
- tjera:

### NEGLIZHIM

- lënia pas dore
- braktisja
- tjera:

### Të dhënat personale të rastit

Emri dhe Mbiemri:

Data lindjes:

Gjinia:

Nacionaliteti/etnia:

Vendlindja:

Vendbanimi/vendqendrimi:

Gjendja shëndetësore:

Aftësi e kufizuar:

Të tjera

### **Situata aktuale e rastit**

**Prezantimi në TNMR i vlerësimit të rastit nga ana e menaxherit të rastit i fokusuar në nevojat e fëmijës/familjes dhe në sigurinë e tyre.** *(Të përshkruhen nevojat e plota të fëmijës në harmoni me moshën, shëndetin, zhvillimin, edukimin, përfshirjen, rrezikun, sigurinë dhe përfshirjen e fëmijës/familjes)*

*Prezantim nga Menaxheri i Rastit për shërbimet e ofruara dhe koordinuara nga Qendra për Punë Sociale para se rasti të referohet në TNMR (listo shërbimet dhe datat).*

**Ndarja e informacioneve për rastin gjatë diskutimit në TNMR** (*Gjatë takimit në TNMR, anëtarë /pjesëmarrësit ofrojnë informacione me qëllim të rivlerësimit të nevojave të fëmijës*).

## PLANI INDIVIDUAL I UNIFIKUAR PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

*Përcaktimi i qëllimit: specifik, i matshëm, i arritshëm, i dakorduar, relevant, ndarja e përgjegjësisë dhe i afatizuar në kohë.*

**Synimi:** *fëmija është i sigurt, faktorët e rrezikut janë zvogëluar, promovimi i interesit më të mirë dhe plotësimi i nevojave të përgjithshme dhe specifike të fëmijës, përfshirja dhe përkrahja për familjen.*

### Bashkrendimi dhe koordinimi i veprimeve në ofrimin e shërbimeve për mbrojtje, rehabilitim, integrim dhe riintegrim të fëmijës

<b>Veprimet dhe Masat</b>	<b>Shërbimet</b>	<b>Institucionet përgjegjëse</b>	<b>Data e planifikuar e realizimit</b>	<b>Statusi i realizimit të veprimit (në proces, i kryer, i pakryer)</b>	<b>Afati rishikimit i veprimit</b>	<b>Shënime</b>



	<b>Pjesëmarrësit e ftuar/emrat dhe mbiemrat</b>	<b>Institucionet/OJQ</b>	<b>Prezent</b>	<b>Nënshkrimi</b>
<b>1</b>				
<b>2</b>				
<b>3</b>				

**Rishikimi i planit dhe vlerësimi i progresit**

**Data:** \_\_\_\_\_

<b>Veprimet</b>	<b>Shërbimet</b>	<b>Institucionet përgjegjëse</b>	<b>Data e planifikuar e realizimit</b>	<b>Statusi i realizimit të veprimit (<i>në proces, i kryer, i pakryer</i>)</b>	<b>Vlerësimi i progresit</b>	<b>Shënime</b>

**Mbyllja e rastit për TNMR:** sheno në njëren nga rubrikat, në raste të veqanta sheno me fjalë tek rrethanat tjera

fëmija është jashtë rrezikut

fëmija është mbi 18 vjeç

kur fëmija ndërron vendbanimin brenda shtetit

kur fëmija ndërron vendbanimin jashtë shtetit

fëmija vdes

Rrethana tjera:

	<b>Pjesëmarrësit e ftuar/emrat dhe mbiemrat</b>	<b>Institucionet/OJQ</b>	<b>Prezent</b>	<b>Nënshkrimi</b>
<b>1</b>				
<b>2</b>				
<b>3</b>				
<b>4</b>				